

**AKT- THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“HALIF CONSTRUCTION” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “HALIF CONSTRUCTION” Sh.p.k.

- 1- ABDALLA HASSAN AHMED HUSSEIN atesia HASSAN , shtetas EGYPTIAN , lindur me 29.03.1991 ne FAYOUM, identifikohet nepermjet pasaportes A20952837.
- 2- EID KHALIFA MOHAMED GABALI atesia KHALIFA, shtetas EGYPTIAN ,lindur me 16.10.1981 ne FAYOUM, identifikohet nepermjet pasaportes A26909830.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “HALIF CONSTRUCTION” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise “HALIF CONSTRUCTION” Sh.p.k.,

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI3  
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “DESHMORET” Lagja nr. 4,Godina me xhama ,afër karburant ALPET ,kati i 3 , Zyra 42,Nr. Pronesie 6/62,zona kadestrale 8514, Durrës, Shqipëri.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda

ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

#### NENI 4

#### KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi, sipas rasteve të parashikuara me ligj.

#### NENI 5

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "HALIF CONSTRUCTION" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe shërbimeve ndaj shoqërive në Republikën e Shqipërisë dhe në territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj:

#### 5.1 PUNIME NE FUSHEN E NDERTIMIT .

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve të ndryshme. Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

#### NENI 6

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 LEKE (Njëqind mijë Leke), i ndarë në 2 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

1.ABDALLA HASSAN AHMED HUSSEIN	50,00%
2.EID KHALIFA MOHAMED GABALI	50,00%

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer tërësisht dhe depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

#### NENI 7

#### AKTET E SHOQERISE

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e

Shqipërise.

## NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “HALIF CONSTRUCTION” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administratorët e shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emeruar:

1. ABDALLA HASSAN AHMED HUSSEIN

2. EID KHALIFA MOHAMED GABALI

3. JONA LUGA

Te cilet mund te ushtrojne kompetencat e tyre se bashku ,ose edhe vec e vec .

## NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.


**Tirane 19/11/2020**

### ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE “HALIF CONSTRUCTION” SH.P.K.

ABDALLA HASSAN AHMED HUSSEIN



EID KHALIFA MOHAMED GABALI



AKT THEMELIMI “HALIF CONSTRUCTION”